



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3041/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit i Kolegjit Dardania:

- Menaxhment dhe Biznes Digjital, BA, 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Kolegji Dardania ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programit të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1	Menaxhment dhe Biznes Digjital, BA, 180 ECTS Akreditim	Albulena Shala Bekim Stafai Gezim Turkeshi

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Dardania, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit.

Vizita është organizuar më 27.05.2021, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Dietmar Paier, Asnate Kazoka.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


1. Për programin e studimit Menaxhment dhe Biznes Digjital, BA, 180 ECTS, - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë substancialisht dy (2), dhe pjesërisht pesë (5).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 dhe 27 korrik 2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Dardania dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Dardania;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

